

VENDIM
Nr. 683, datë 11.9.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT ÇUKË–BËRBËNESH”, BASHKIA SARANDË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Ndërtimi i Ujësjellësit Çukë–Bërbënesh”, Bashkia Sarandë.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve.
3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “kullotë”, me një vlerë të përgjithshme prej 283 200 (dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 283 200 (dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind) lekësh, përballohet nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve.
8. Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Në momentin e ekzekutimit të procedurave për likuidim, për pasurinë, pronë private, që shpronësohet me anë të këtij vendimi, masa e shpërblimit do të vendoset në një llogari të posaçme bankare dhe do t’i vendoset në dispozicion personit që rezulton nga vendimi i formës së prerë të gjykatës, në përputhje me pikën 2, të nenit 16, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar.
10. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Sarandë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasurinë që shpronësohet, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve.
12. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi

13. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Sarandë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)					Vlerësimet për shpronësim, sipas llojit të pasurisë				Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m ²)	“Kullotë”			Vlera totale	
									Sipërfaqja (m ²)	Cmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)		
1	Refije Artan Elvin	Hamdi Faik Faik	Islamaj Islamaj Islamaj	Ksamil	2297	1/785	Kullotë	144,750	1,600	177	283,200	283,200	Seksioni D: 1. Në bazë të vendimit nr. 23-2015-749, datë 14.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është vendosur marrja e masës së përkohshme të sigurimit të padisë dhe vendosje e sekuestros konservative mbi këtë pronë. Sigurim padie
Vlera totale												283,200	